

VENDIM
Nr.35, datë 6.4.2011

**PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERALD
ENERGJETIK” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3, neni 16 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.4.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Erald Energjetik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

- Ndryshe nga përcaktimet e kontratës koncesionare të datës 16.6.2009 (nenet 2 dhe 3 në të cilat përcaktohet ndërtimi dhe vënia në punë e dy heceve: hec “Shemri” me fuqi 800 kW dhe hec “Mgulle” me fuqi 280 kW), shoqëria “Erald Energjetik” sh.p.k. ka paraqitur në ERE aplikimin për licencim vetëm për hec “Shemri”, ndërsa për hec “Mgulle” nuk është paraqitur asnjë dokumentacion.

- Dokumentacioni i përgjithshëm për hec “Mgulle”, neni 9 pikat 1,2,3 dhe 4 nuk është plotësuar.

- Dokumentacioni i përgjithshëm për hec “Shemri”, neni 9 pikat 1,2,3 dhe 4 është plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurat e shqyrtimit të aplikimit për licencimin e shoqërisë “Erald Energjetik” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
NË DETYRË
Entela Shehaj